Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së shtetit. Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: KSHPK) në seancën e 66-të të mbajtur më 21.04.2022 ka miratuar

Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-1325/1 datë 22.02.2020, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm nga KSHPK- ja sipas lëndës me numër 08-1325/1 të datës 22.02.2020.

Lënda me numër 08-1325/1 datës 22.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-1325/1 të datës 22.02.2020 është formuar me vetiniciativë në bazë të Planit Vjetor për monitorimin e situatës së pronës dhe interesave për vitin 2020.

KSHPK, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, mori të dhëna për pasurinë e ---------- dhe anëtarëve të familjes së tij nga Agjencia për Kadastër të patundshmërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e të Hyrave Publike, Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas shqyrtimit të të dhënave të marra nga institucionet e përmendura, si dhe krahasimit të tyre me të dhënat nga fleta anketuese e ----------, prokuror publik në ----------, KSHPK-ja konstaton se nuk ka elemente për veprimin e mëtutjeshëm të saj në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti:Mr. Nikolina Tarçullovska-Miloshevska, këshilltare
Miratoi: Goran Trpenoski, anëtar

KOMISIONI SHTETROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami